



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e –III-

**KOMISIONI PARLAMENTAR PËR BUJQËSI, PYLLTARI,
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM
HAPËSINOR**

Procesverbal Nr. 6
nga mbledhja e mbajtur më **7.4.2008**
kryesuar nga **Lulzim Zeneli**-kryetar i komisionit
Mbledhja filloi në orën 11,00

Të pranishëm :

Lulzim Zeneli kryetar i Komisionit, Ibrahim Selmanaj, Berat Luzha, Zef Morina , Heset Cakolli , Myrvete Pantina dhe Ali Lajçi .

Munguan :

Kosara Nikolić, Selvie Halimi, Elheme Hetemi dhe Zylfi Merxha.

Nga Sekretaria e Kuvendit : Bajram Badivuku dhe Lule Ymeri.

Pjesëmarrësit tjerë : Tirana Baftiu, Jashar Kastrati dhe Laura Zherka si
dhe vëzhguesi nga presidenca dhe OSCE

RENDI I DITËS U PËRMIRËSUA DHE U MIRATUA PA VËREJTJE :

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Projektligji për Shitjen e Banesave në të cilat ekziston e drejta banesore,
3. Të ndryshme

1.Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua .

2.Projektligji për Shitjen e Banesave në të cilat ekziston e drejta banesore

Kryetari Lulzim Zeneli para se të shqyrtohet në detale **projektligji për Shitjen e Banesave**, hapi diskutimin rreth projektit në fjalë, i cili në mandatin e dytë nuk ka

përfunduar procedurën parlamentare. Përfaqësuesit e MMPH u pajtuan që shqyrtimi dhe amendamenti të shkojnë bashkërisht nën për nën. Kryesuesi kërkoi nga anëtarët e komisionit shqyrtimin e amendamenteve nga mandati i kaluar, me çka komisioni u pajtua.

Amendamenti 1

Preambula riformulohet :

”Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të Kreut 5 neni 5.1 (i) dhe Kreut 9 neni 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme të Kosovës (Rregullorja nr. 2001/9),

Me qëllim të krijimit të kornizës ligjore për krijimin e mekanizmave dhe kushteve të banimit sipas standardeve të Bashkimit Evropian:

Miraton :

Projektligjin për Shitjen e Banesave në të cilat ekziston e drejta e banesës”

Komisioni përkrahu riformulimin, por me sugjerim që Korniza Kushtetuese nuk do të vlejë prej qershorit e andej.

Amendamenti 2

Neni 1 riformulohet :

Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra e shitjes së banesave në të cilat ekziston e drejta banesore, së bashku me pjesët e përbashkëta dhe pajisjet e ndërtesës, si dhe mënyra e përcaktimit të çmimit shitës të banesës.

Zef Morina kërkoi nga përfaqësuesit e MMPH-së të sqarohet termi “pajisjet e ndërtesës”, në çka zyrtarët e ministrisë dhanë sqarime për kuptimin e termit.

Amendamenti 3

Propozim nga deputeti Gani Koci

Neni 1 ti shtohet paragrafi 2:

Veç banesave të trajtuara në al.1 të këtij neni , me të njëjtën të drejtë për shitje trajtohen edhe banesat të cilat kanë filluar të ndërtohen para 25.6.1999 me mjete të fondeve të përbashkëta të ndërmarrjeve publike dhe shoqërore, dhe të cilat për shkaqe objektive (luftës) kanë përfunduar pas 25.6.1999 dhe tani e kanë statusin e banesave të ndara punëtorëve të këtyre ndërmarrjeve , me qira ekonomike.

Pasi që amendamenti në fjalë ishte jo shumë i qartë për komisionin, Gani Koci-parashtruesi i propozim amendamentit prezantoi në mbledhje dhe sqaroi se KEK-u pas luftës ka përfunduar banesat e filluara para luftës. Pas vitit 1999 disa banesa janë përfunduar me ndërtim dhe u janë dhënë në shfrytëzim punëtorëve me pagesë ekonomike për puntorët.

Gani Koci i siguroi anëtarët e komisionit se këto banesa dallohen nga ato që janë kontestuese sa i përket pronësisë, ngase banesat e YU programit ashtu edhe ashtu janë të legjitimuara dhe të shitura.

Heset Cakolli konstatoi se 44 banesat e Universitetit janë pa titullarë, çka edhe Gani Koci e vërtetoi këtë konstatim, ngase ato janë në kontest Gjyqësorë, dmth nuk do të përfshihen me këtë ligj.

Lulzim Zeneli shprehu mendimin se për këtë amendament komisioni duhet të deklarohet në mbledhjen e radhës, ndërsa Berat Luzha insistoi që sot të përfundoi komisioni shqyrtimin e këtij projektligji.

Ibrahim Selmanaj tha se nuk është mirë që në këtë amendament të qëndroi data e vitit 1999 ashtu si është.

Lulzim Zeneli përfundoi lidhur me këtë amendament duke kërkuar nga MMPH të përgatiten me informata të duhura deri në mbledhjen e radhës.

Amendamenti 4

Neni 2, riformulohet përkufizimi :

“Bartës i së drejtës banesore” – personi ose anëtarët e ngushtë të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës banesore të cilit i është ndarë banesa - i është dhënë në shfrytëzim dhe i cili ka lidhë kontratë mbi shfrytëzimin e banesës.”

Shtohet përkufizimi :

“Ministria” do të thotë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Amendamenti 5

Neni 3, fshihet.

Amendamenti 6

Neni 4.1 riformulohet :

“Banesa shitet me pjesët e përbashkëta dhe pajisjet e ndërtesës të cilat i shërbejnë ndërtesës si tërësi. “

Amendamenti 7

Neni 6.1 , fjala **“themeluar”** zëvendësohet me fjalën **“dalë”**.

Neni 6.2 riformulohet :

“Shtetasi i huaj mund të blejë banesë sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj.”

Amendamenti 8

Neni 7.1 riformulohet :

Çdo bartës i së drejtës banesore, gjegjësisht shfrytëzues i banesës në pronësi shoqërore apo publike përveç në rastet nga neni 15 i këtij Ligji, mund t’i paraqesë kërkesë me shkrim për blerjen e banesës bartësit të së drejtës që ka në disponim banesën në pronësi shoqërore, **respektivisht pronari i banesës publike i cili shet banesën.**

Nenit 7 i shtohet paragrafi 6 :

(6) . Shitësi është i obliguar që në afat prej tre muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të informoj bartësin e së drejtës banesore, gjegjësisht shfrytëzuesin e banesës për të drejtat e tij të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji.

Amendamenti 9

Neni 11.1 dhe 11.2 fshihen.

Komisioni përkrahu këto amendamente.

3.Të ndryshme

Komisioni do të vazhdoi me shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjit ditën e enjte.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 12,50

Bajram Badivuku

Admin. i Komisionit,

Kryetari i Komisionit,

Lulzim Zeneli